



Pranuar / Dorezuar Puniljeno/Prodato Received/Delivered	17.01.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMSHCK	443/2023		112



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.1121/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Ilire Mehmeti Shaqiri në cilësinë e procesmbajtëses, duke vepruar sipas ankesës me numër A.nr.1121/2022 të datës 08.12.2022 të parashtruar nga ankuesja në çështjen juridike “shkelje e së drejtës në pagë”, në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 nënparagrafin 1.1, nenit 16 paragrafi 3 dhe nenit 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 17.01.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

Përfundon procedimi administrativ ankesa me numër A.nr.1121/2022 e datës 08.12.2022 e parashtruar nga ankuesja

**A r s y e t i m**

Ankuesja Zyrtare Administrative në Komunën e Shtimës, më datë 08.12.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 7779/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes të datës 18.07.2022 të Menaxherës së Zyrës së Personelit të Komunës së Shtimës, lidhur me harmonizimin e koeficientit nga pesë (5) në koeficientin gjashtë (6) si dhe kompensimin për mos harmonizimin e koeficientit nga data 15.03.2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 13.12.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Shtimës. Ndërsa, kjo e fundit më datë 19.12.2022 ka përcjell shkresat lidhur me çështjen në procedurë të vendosjes.

Kolegji i Këshillit duke marr parasysh së pretendimet ankimore të ankueses kanë për objekt çështjen e realizimit të koeficientit të pagës, thekson faktin së Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 22.12.2022 ka aprovuar Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, i cili me datë 05.01.2023 është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.1/5 Janar 2023, dhe si rrjedhojë i njëjti hynë në fuqi një (1) muaj pas publikimit në gazetë zyrtare. Me këtë ligj parashihen rregulla dhe kushte tjera për përcaktimin e pagës të të punësuarve në sektorin publikë, duke përfshi edhe koeficientet dhe nivelet e koeficienteve të pagës të cilat ndryshojnë nga rregullat dhe sistemi aktual i pagave.

Për me tepër, me dispozitat kalimtare të këtij ligji shfuqizohet Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, ndërsa me nenin 42 paragrafi 1 është përcaktuar së gjatë periudhës tranzitore të kalimit në sistemin e ri të pagave, ndalohet çdo ndryshim në strukturën, komponentët apo nivelet e koeficienteve aktual të pagave.

Andaj, për sa me sipër dhe duke marr parasysh faktin se pas parashtrimit të ankesës nga pala ankuese kanë ndryshuar rrethanat ligjore dhe faktike mbi të cilat janë ngritur pretendimet ankimore, Kolegji i Këshillit konstaton se objekti për të cilën ka filluar procedimi administrativ është bërë i pamundur apo i kotë, ngase edhe nëse do të kishte vendimmarrje pozitive, për shkak të rrethanave të krijuara si pasojë e bazës së re ligjore, koeficienti i ndryshuar i pagës nuk mund të aplikohet në sistemin e ri të pagave.

Kështu që duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 104 ku përcaktohet se: *Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë*, si dhe nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi për përfundimin e procedimit administrativ, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.1121/2022

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Proçesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi  
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Shtimës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.